

VITI XV, NUMRI 2 / SHKURT 2011

# FOREVER



HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA



CONQUISTADOR CLUB 2010  
PRESIDENT'S CLUB 2011  
TOP DISTRIBUTORS 2010



# Ndryshimi i një grade

**D**o të dëshiroja tju shtroja një pyetje- Çfarë ndodh me ujin në 99°C?  
Përgjigja do të ishte: Nuk do të ndryshonte shumë, vetëm do të ishte shumë i nxehtë.  
Po çfarë do të ndodhë po ta rritim temperaturën edhe një gradë?

Përgjigja do të ishte: Do të kemi ujë të valuar.

Atëhere, mund të thoni, po çsensacion përbën ky fakt?

Uji që valon prodhon avull. Një herë e një kohë avullin e përdorën për vënien në lëvizje të motorrave me avull. Dhe motorri me avull nga shumë historianë është konsideruar si shpikja më e rëndësishme që i hapi rrugën Revolucionit Industrial sepse siguroi një burim të pershtatsbëm energjie duke krijuar mundësi të mëdha për rritjen dhe lulëzimin e prodhimit dhe të transportit.

Në fakt edhe sot akoma 80% e energjisë elektrike në botë sigurohet nga turbinat me avull.

Pra e kuptoni se vetëm me rritjen e një grade celsius, ndryshoi kursi i historisë botërore.

Ndryshim i një grade të vetme, është mesazh i thjeshtë por shumë i fuqishëm që na kujton të gjithëve sesi edhe një ndryshim i vogël përpjekje dhe vëmendje mund të sjellë një ndikim të madh në rezultatit përfundimtar.

Ju propozoj që ta aplikoni këtë parim në biznesin e Foreverit. Ç' do të ndodhë sikur ne të shpenzojmë edhe një orë në ditë më shumë në veprimtarinë e sponsorizimit dhe të ndërtimit të rrjeteve? A do të sjellë ndonjë ndryshim vërtet? Ju garantoj, po, do të sjellë!

Kjo do të thotë se bëhen 365 orë në vit që janë të barabarta me 15 ditë pune për sponsorizimin dhe ndërtimin e rrjeteve. Dy javë plus mund tju ndihmojnë juve të siguroni 150 pikë të nevojshme për të arritur nivelin „Profit Share”. Po sikur të ftoni edhe një njeri më shumë në Rally-in e Amerikës? Ndofta mund të dalë që ai të jetë Menaxheri apo Diamant Menaxheri juaj i ardhshëm. Sigurisht kjo do të ishte një ndihmë shumë e madhe edhe në biznesin tuaj.

Pra kjo e vërtetë e thjeshtë, e ndryshimit qoftë edhe me një gradë të vetme mund të sjellë një ndryshim të madh në biznesin tonë, në familjet tona, në shëndetin tonë dhe në çfardo objektivi që ju i keni vënë vetes për vitin 2011. Ajo që mund të duket si një sasi e vogël energjie, mund të sjellë një sukses të jashtzakonshëm, nëqoftëse ne i bëjmë këto përpjekje.

Le të jetë objektivi ynë për 2011, kalimi në temperaturën 100°C! Të mos mjaftohemi me 99°C! Mos harroni, NUK KA KUFË! Vijeni në punë edhe atë energjinë e vogël plus. Mbajeni mend, gjendja ndryshon edhe vetëm me një gradë!



REX MAUGHAN  
DREJTOR I PERGJITHSHËM



**N**e do të krijojmë një mjedis fitimprurës ku individë, me dinjitet, të jetojnë ashtu siç dëshiron: ku integriteti, dashuria dhe argëtimi të jenë udhërrëfyesit tanë. Ne do të krijojmë dhe mbështesim pasionin dhe besimin tek kompania jonë, tek produktet dhe tek dega e industrisë sonë. Ne do të kërkojmë dije dhe ekuilibër, dhe mbi të gjitha ne do të drejtojmë me guxim kompaninë dhe distributorët tanë.

Para së gjithash unë mendoj se çdo ditë ne duhet të pyesim veten "A po krijojmë një mjedis fitimprurës dhe me rendiment?" Unë këtu nuk e kam fjalën për fitimin dhe rendimentin në kuptimin e thjeshtë financiar të këtyre fjalëve- megjithëse edhe këto janë jashtzakonisht të rëndësishme. Por më tepër unë dua të pyes secilin nga ne "A është kjo mënyra se si duhet ta shpenzoj kohën çdo ditë për të ndihmuar veten të arrij objektivat e mia?". Të gjithë jemi shumë të zënë dhe na duhet të bëjmë shumë më tepër sesa kemi perfunduar ndonjëherë. Megjithatë, këtë vit bashkëpunëtorëve të mij unë u kam hedhur sfidën, jo të jenë sa më të zënë... por të jenë sa më produktiv.

Të jemi më produktiv në biznesin tonë, në jetën tonë personale, në veprimtarinë tonë argëtuese. Çfardo që të bëni, e bëni me një synim, me një fokusim për realizimin e diçkaje të madhe. Integritet, dashuri, dhe argëtim. Shpesh ju nuk i dëgjoni këto tre fjalë që të përdoren sëbashku. Por unë besoj se janë tre fjalët më të rëndësishme që më kanë mësuar prindërit e mij. Ta jetoj jetën time me integritet, në atë mënyrë që askush të mos dyshojë në ato që them apo që bëj – kjo është morale, etike dhe e ndershme. Të kem dashuri për ata që më rrethojnë, që ata ta dijnë gjithmonë që unë tregoj kujdes për ta, për familjet e tyre, dhe për gjërat e mëdha që ata përpiqen të realizojnë. Dhe sigurisht, të argëtohem sepse jeta ikën shumë shpejt, dhe pamvarsisht nga gjithë pengesat që ndeshim, jeta është e madhe dhe ne duhet të ngrihemi mbi sfidat e saj dhe ti gëzojmë momentet e veçanta të saj.



# Guxim PËR TË NESËRMEN

Pasion për kompaninë, për produktet dhe për këtë biznes. Ky passion shkon shumë më larg se një besim i thjeshtë. Ne duhet të përqafojmë fuqishëm gjithshka ofron kjo kompani. Kur ju zhvilloni këtë passion, njerzitet do ta ndjejnë atë, dhe do të duan të jenë pjesë e saj, për shkak të asaj që shohin tek ju. Kështu ky parim i vetëm mund sjellë ndryshime të jashtzakonshme midis arritjes të një suksesi të madh dhe thjeshtë heqjes zvarrë.

Dhe së fundi guxim. Fjala guxim në fjalor percaktohet si shpirti që i jep mundësi njeriut tu bëjë ballë vështirësive. Të gjithë ne në jetën tone ndeshemi me sfida. Ajo që bën dallimin midis suksesit dhe dështimit është guximi për ti mposhtur këto sfida dhe për të ecur përpara. Nuk është gjithmonë e lehtë, por gjithmonë ia vlen ngase në përfundim të kësaj përpjekje arrijmë të ndryshojmë jetën tone e të familjeve tona dhe jetën e atyre që janë angazhuar në biznesin tone.

Për të përmbledhur gjithë sa thamë, unë e ndjej se ky deklaram misioni në realitet është për "krijimin e madhështisë". Në fakt kur njerzitet më pyesin çfarë bën Foreveri, unë nuk u them atyre se ne jemi firmë e marketingut në rrjet (MLM) që prodhon produkte me bazë aloe vera, por thjeshtë u them "ne krijojmë madhështi". Kjo është ajo që unë dua dhe që shpresoj se edhe ju do të angazhoheni ta bëni. Unë gjithashtu ju angazhohem se ky deklaram misioni nuk do të mbledhë më pluhur në qoshen e zyrës time. Ndërkohë që këto parime gjithmonë kanë qënë pjesë e jetës time, unë do tu rikthehem atyre sa herë percaktojmë objektivat dhe bëjmë planet për zhvillimin e Foreverit. Vërtet Nuk Ka Kufij në sukseset që mund të arrijmë sëbashku ngase ne përqafojmë dhe jetojmë me këto parime. Ne vlerësojmë gjithshka ju bëni për ta zhvilluar Foreverin si mundësinë më të madhe në botë dhe unë ju uroj juve dhe familjeve tuaja një Vit të Ri të lumtur dhe të sigurtë.

GREGG MAUGHAN  
PRESIDENT I FLP





# Solidaritët

**M**e afrimin e ditës të Shën Valentinit të mendojmë edhe për atë se ç'do të thotë ruajtje e mardhënieve njerëzore, e dashurisë, e respektit, e bashkjetesës dhe e miqësisë. Lidhje të afërmish, fije miqësie, lidhin gjithë vendin; këto gjëra përbëjnë vlerat më të mëdha. Duhet të kujdesemi ti ruajmë mardhëniet tona, sepse ti prishësh ato është shumë lehtë, por ti ndreqësh duhen ndofta edhe vite. Nderi i fjalës së dhënë është vendimtare në jetën e njeriut. Mjafton një takim duarsh për të lidhur një biznes.

Katërmëdhjet vjet më parë, në Shkurt 1997 i dhamë dorën njeri tjetrit me Rex Maughan, themeluesin dhe Drejtorin e atëhershëm të Forever Living Products International. I dhamë dorën njeri tjetrit dhe filloi një sipërmarrje e përmasave të tilla të mëdha, që sot është përcaktuese jo vetëm në Europë por edhe në gjithë botën! Të ruajmë nderin e fjalës së dhënë, të mos lejojmë ta deformojmë atë, të shkëputemi prej atyre që fjalët nuk i shoqërojnë me vepra. Gjatë 14 viteve kemi ndërtuar një sipërmarrje të mrekullueshme me njerëz fantastikë, me drejtues që fluturojnë lart. Gjithnjë e më tepër duket në botë, që në këtë grup firmash zhvillohen dhe bëhen drejtues të vërtetë ata, që me fjalë dhe me vepra reflektojnë gjithmonë të vërtetën, të mirën dhe ndershmërinë. Për ne 2011 do të jetë një vit vendimtar!

Niset përse duke zburmuar Foreveri me një skuadër unike dhe të përforcuar, që tash drejtohet jo vetëm nga Drejtori i Përgjithshëm Rex Maughan, por edhe nga zoti president i firmës Gregg Maughan, duke përcaktuar objektiva të guximshëm për të ecur gjithnjë e më përpara.

Foreveri nuk është biznes vetëm i të sotmes por edhe i të nesërmes! Ajo që përveç interesave të biznesit na mban së bashku, ajo nuk është gjë tjetër veçse miqësia, respekti, e diku edhe dashuria. Me rastin e ditës të Shën Valentinit uroj që gjithsecili ti gëzojë këto ndjenja! Të dhurojmë respekt, dashuri, me zemër të pastër, me ndjenja të thella, dhe le të jetë kjo ditë Dita e Solidaritetit!

Përpara Forever!



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Dr. Milesz Sándor'.

DR. MILESZ SÁNDOR  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM



# Success Day

BUDAPEST, 15 JANAR

FOREVERI NA SOLLI DITËN E PRANVERËS (OSE MË MIRË TË THEMI DITËN PRANVERORE). MEGJITHSE SHKRUAJMË PËR JANARIN, JEMI NË NJË DITË ME DIELL TË NDRITSHËM. NË FOREVER EDHE VITIN KËSHTU E IMAGJINOJMË, PAMVARSISHT SE ÇFARË SHKRUHET NË „LIBRIN E MADH”, NE EDHE DIMRIN E KTHEJMË NË PRANVERË.

**N**jë Ditë Sukcesi në vetvete , ka një emocion tek njerzit, sepse duhet shkuar në një vënd të ri të organizimit të këtij aktiviteti! Lëvizje e madhe e hutim para hyrjes të pallatit të aktiviteve „SYMA”. Ku do të parkojmë? A jemi në portën e duhur? Këtu blihen biletat? Sigurisht një vit quhet vërtet i ri kur sjell edhe risi. Në vënd të stadiumit të mëparshëm ku jemi mësuar, kalojmë në një vend të ri që nuk na lë të dembelosemi dhe që na nxit për hapa të reja, për mendime të reja. Psh tani ne vrasim mendjen a do ta arrijmë fillimin e ceremonisë sepse është një radhë që nuk i duket fundi. Thuajse është e pabesueshme që kur kënga e **Lui Túri Lajos** arrin nga fundi, pjestarë e Foreverit dhe gjithë miqtë e tjerë, arrijnë të gjejnë vendet e tyre. Që faktikisht kështu është na i thonë drejtuesit e programit





**Tibor Lopicz** dhe **Orsolya Lopiczné** – Senior Menaxherë, të cilë shprehen: „Jeni në vëndin më të mirë në kohën më të mirë”. Sipas traditës Ditën e Suksesit dhe bashkë me të edhe Vitin e Ri e hap Drejtori i Përgjithshëm **Dr Milesz Sándor** dhe duke uruar për një vitt ë ri të lumtur ai shprehet „Mbyllëm një vitt ë bukur ,por 2011 do të jetë edhe më i bukur”. Kjo dita e sotme deri në fund flet për këtë vazhdimësi: përgjithësimin e rezultateve të deritanishme dhe orintimet e reja. Festojmë rezultatet e larta të vitit të kaluar, por hedhim shtratin për arritje të reja. Si hap të parë Dr. Milesz Sándor shpall listën emërore të anëtarëve të Klubit të Presidentit. Distributorët më të mirë të vitit ngjiten në skenë duke kaluar para pjesmarrësve që duartrokasin të ngritur në këmbë. Vetëm ai që është këtu, punon edhe për atë që një ditë të arrijë deri në këtë podium. Dhe atëhere ndoshta nuk do të jetë e pamundur, që të dhurosh një CD apo një libër, sepse esenca kjo është, që përvojën dhe dijet e fituara të mos i mbash për vete por ti percjellësh më tej. Drejtori i Përgjithshëm uron një e nga një të suksesshmit e vitit 2010.

Megjithse në mënyrë festive mbyllëm garën e Yjeve të Foreverit, edhe talente të reja ka njaft dhe nuk mbetemi pa numura programi të mrekullueshëm. Sadoqë pjestaret e grupit të valleve „Piruett „ janë 10 vjeçare, me lëvizjet e



bukura harminike ato i kërcejnë njëlloj si vallet klasike ashtu edhe ato moderne. Eshhtë një gjë e bukur , që përpara se të diskutohet për çështje më serioze, të shikosh këto vajza elastike.

Bisedën e parë profesionale të vitit e mban Dr Milesz Sándor me titullin „Bima medicinale më popullore e Shek.21”. A e dini? Sigurisht fjala eshte për Aloe Vera. Ndërkohë flet për një libër të planifikuar për tu botuar në muajin Maj, përgatitja e të cilit është rezultat i një pune studimore të gjatë. Rezultat shkencor i madh, material profesional që duhet parë sepse aloe është një nga temat e kësaj fushe, e studjuar në mënyrë më intensive sot. Pra ka ardhur koha të përmbledhet çfarë dihet deri më sot për këtë bimë. Edhe ata që kanë interesa të kundërta, edhe ata që janë dyshues e pranojnë që në këtë bimë gjenden lëndët me efektin më të mirë për uljen e inflamacioneve. Nga një numur shkrimesh të lashta dhe nga relike materiale del se forca e bimës të aloes me 360 varietete ka qënë e njohur që në kohët e lashta. Në bisedën interesante të Dr Milesz mund të gjejmë shëmbuj që nga mbretëresha Nefretiti deri te konti Bercsenyi që shpalsin magjinë e kësaj bime.



Pastaj na jepet një pasqyrë e rezultateve shkencore, për studimet e viteve 80-të, për atë proces ku edhe shkencat mjekësore filloi të pranojnë se tek aloe gjendet gjithshka e nevojshme për funksionimin normal të organizmit tonë. Sipas njohurive të deri tanishme bëhet fjalë për më tepër se 200 lëndë të efektshme, me një listë të gjatë vitaminash, lëndësh minerale, aminoacidesh që janë në sinerji me njëra tjetrën. Pijeni, përdoreni, shijojeni energjinë e koncentruar, sepse brënda ka urtësinë e botës- e përfundon bisedën e tij Dr Milesz Sándor, që pastaj thërret në skenë mjekët që janë aktivë me Foreverin dhe duke treguar këtë bimë ju uron atyre: „Ruajeni edhe për katër mijë vjet”!

Nuk ka nevojë që njeriu të jetë mjek që të ngjitet në skenë. Këtë tashmë na i vërteton edhe kualifikimi i supervisorëve dhe asistent supervisorëve. Lule, urime, pastaj – që festuesit të shikojnë edhe shkallët që pasojnë- vazhdon **Anikó Kardos** menaxherja e sapo kualifikuar e Szekésféhérvárit, e cila për herë të parë zhvillon bisedën e saj nga podiumi i Ditës të Suksesit.

Distributorja e prodhimit të veshjeve, ka punuar si sipërmarrëse që në moshën 21 vjeçe. Dhe ja si i kujton ajo ato kohë :”Isha skllave e vetvetes – shprehet ajo”.



Sipas Anikós ndërtimit të rrjetit mund ti futet me sukses ai që në fillim sakrifikon një çikë vetë, domethënë të arrij një pikë që të dalë nga strofulla e ketrit. Një përballje , ku guxon të largohet nga ajo që ka bërë deri tani. Menaxherja e re nuk i lë pa përmendur edhe vështirësitë. „Edhe unë kam hasur mjaft vështirësi... duhet të jesh e vetëdijshme edhe për ndjenjat e njerzve, qofshin këto edhe negative, ndryshe nuk do të ishte i qëndrueshëm ky biznes... Nqse diçka e prek me dhimbje , duhet shikuar çfarë duhet të mësojmë prej saj”. Këtë Aniko e përmbledh kështu „Unë jam ndërtuese vlerash”. Në këtë ide përfshihet edhe ajo që ti pranojmë bashkpunëtorët e këtij biznesi, pa u vënë kushte. Sigurisht në radhë të parë për të ndryshuar vetveten tonë. Edhe ajo shpesh ka shtruar pyetjen: „a jam kaq e mirë?” Të ardhurat vërtetuan atë, që madje shumë e mirë. „Le të bëhemi bashkë diamantë”- përsëhendet duke u larguar njeriu i suksesit.





Nqse Anikó (apo çdonjeri nga ne) ndesh edhe një të vetëm me shpirt të ngjashëm me të, atëhere bëhet një skuadër, dhe mund të nisë ndërtimin e një skuadre të madhe. Sesi dhe qysh, këtë na i tregon Soaring Menaxherja **Márta Zsiga** „ Eshte vëhtirë të ndryshosh të tjerët, vetë ti duhet të ndryshosh. Kërkojmë luftëtar lirije, që mesazhin e lirisë dinë ta çojnë më tej. Ti a ke guxim të jesh i lirë? – pyet ajo. Eshtë me interes që ta bësh atë, mbasi sikurse thotë Márta, 2011-ta do të jetë viti i ripërtëritjes, dhe sot është shumë më lehtë të ndërtosh biznesin sesa 14 vjet më parë. Njerzit kurrë nuk kanë patur kaq nevojë për mundësira që të jenë në gjëndje të sigurojnë të ardhura mbi mesataren”. Márta Zsiga tërheq vëmendjen edhe për atë , që thirrjes sonë do ti përgjigjen shumë lloj njerzish „Mund të vijë kushdo, por do të mbetet vetëm ai që përfaqson frymëzimin me të cilin e nisi **Rex Maughan**” .

Tanimë në skenë rreshtohen ata njerëz që gjithmonë kanë kuptuar dhe e kanë mbajtur të gjallë këtë frymëzim. Dhe nuk kanë sjellë një sukses çfardo! Përshëndesim ata që kanë arritur rezultate më të larta gjatë vitit të kaluar dhe në muajin Dhjetor: shpallet lista emërore e Klubit të Conquistadorëve , pastaj të kualifikuarit si menaxher dhe pjesmarrësit e programit stimulues të veturës. Menaxherë Eagle, të kualifikuarit e World Rally, Distributori i Vitit... dhe ec e thuaj që këtu nuk ti vlerësojnë përpjekjet që bën njeriu. Titullin më lavdërues e merr **Ágnes Klaj**, me të cilën lidhet surpriza më e madhe (krejt e freskët), që tashmë mund të referohemi si Soaring menaxhere.

Ajo që vazhdon pas kësaj me siguri është një nga traditat më prekëse në FLP: radha e gjatë e të sapo kualifikuarve që kalon në tribunë në breshërinë e luleve , të perqfimeve dhe të lotëve të gëzimit. Edhe ata që qëndrojnë jashtë këtij biznesi preken, edhe ata mendojnë, të arrish këtu mund të jetë vërtet diçka e mrekullueshme. Edhe Ágnes gëlltit lotët, prandaj edhe në fjalën e saj në skenë duke shkuar te mikrofoni bashkë me të shoqin që me zor mban tufat e shumta me lule, ajo thotë „Atë tek e cila beson do ta sigurosh. Kisha besim, prandaj edhe u realizua” „Duhet të jesh e fortë, të jetosh dhe të pushosh ashtu sikurse dëshiron që edhe të tjerët të punojnë” – thotë ajo duke dhënë recetën për soaring, dhe pastaj na siguron se ky vit do të jetë edhe më i lehtë se viti i kaluar. Falnderime







shpreh për familjen e vërtetë që „ka zgjedhur” vecanrisht për bashkëshortin e saj **László Rostás**, që edhe vet ai shprehet me pak fjalë „ ju uroj të gjithë juve, mësoni të krijoni, të krijoni një botë të tillë që ja vlen ta jetoni!”

Pas kësaj nuk kemi dyshim, për atë që kemi filluar, dhe kësaj i referohet edhe **Miklos Berkics** –Menaxheri Diamant-Zafir në bisedën e tij. Kemi filluar me këtë vit, edhe nëqoftëse pushuam pak. Por Miklos Berkics nuk është nga ata që ndalon gjatë, as nuk festoi shumë natën e Silvesterit të Vitit të Ri, por më tepër është marrë me planifikimin e këtij viti. Duket një djalë impulsiv, por gjërat i bën me një vetëdije të pabesueshme. Tani fikson përshembull, atë që tashmë shumë herë e ka përmendur: „Në 2011 në jetën time , në këtë sallë, do të ndodhë gjëja më e madhe”. Dihet perse flet, por hëpërhë të mos e përmendim, le të mbetet surprizë! Por Miklós tashmë flet për planet e bashkësisë duke shpresuar, se ka nga ata që synojnë gjëra të mëdha. „Këtë e pate planifikuar për 2010?- pyet ai, dhe pastaj pergjigjet: Nqse nuk e more atë që kërkoje, atëhere nuk ke punuar sa duhet. Në këtë sipërmarrje nuk mund të bëhesh pishman për punën që bëre. Nqse nuk ke një plan, do të kesh panik dhe jo bonus – thotë ai duke buzëqeshur, pastaj për këtë bën pak matematikë, se kur mund ta presësh çekun e parave. „Do të habiteni! – zbrërthen ai rezultatin, por ajo që është më e rëndësishme: „Atëhere do ti përvishesh punës! Jepi dy vjet, vure në plan të parë Foreverin, puno ditë e natë dhe do të kesh shansin të bëhesh zafir menaxher” – premton ai. Le të ngjitemi së bashku edhe një shkallë menaxhimi në vitin 2011! – kërkon ose më mirë propozon distributori i parë në botë Miklós Berkics, pastaj citon fjalët e Rex Maughan: „Ejani me mua sepse gjëra fantastike ju presin edhe juve në Forever. Nuk duhet të rrini përjashta!”







## HUNGARI



### MIKLÓS BERKICS

Rex Maughan thotë që FOREVER është mundësia më e madhe në botë... dhe ky nuk është vetëm premtim, por në të janë edhe garancitë tona! Të ndihmojmë që të arrihen objektivi. Përpara për Diamant! Miklós Berkics është pjesë e FOREVER-it...

### SÁNDOR TÓTH DHE EDINA VANYA

Dëshira për sukses, besimi në vetvete, besimi tek kompania dhe tek drejtuesit e saj si dhe puna e bërë me dëshirë gjithmonë të çojnë në rezultate të larta.



### ISTVÁN HALMI DHE HALMINÉ MIKOLA RITA

FLP: Është mrekulli të jesh i pavarur! Ta duam jetën, pushimin, punën. Nuk të lodh puna por mungesa e rezultateve. Por ai që punon nuk mund të mos ketë sukses! Ndonjëherë punojmë shumë – ndonjëherë jo shumë. Por jemi ne që vendosim si dhe kur. Kjo është liria e zgjedhjes – kjo është FLP!

### TAMÁS BUDAI DHE ÉVA BUDAI-SCHWARCZ

Një mundësi e madhe për njerëzit e thjeshtë sepse me zell dhe me rezistencë TE GJITHA endërrat tona bëhen realitet! Sipas meje në këtë aventurë shumica janë me ne.



### ARANKA VÁGÁSI DHE ANDRÁS KOVÁCS

Angazhim, zell për punë, objektiva të qarta, Miq të mirë e të shumtë, një Skuadër të madhe, mendime të përbashkëta, temp pune optimale, përballim i disfatave, vazhdimisht krijues.

### HAJNALKA SENK

Carpe diem – Me këtë biznes në çdo moment mund të marr dhe mund të jap më të mirën- tash shtatë vjet Foreveri është pika më e sigurtë e jetës time... dhe kjo më qetëson.







**ÁDÁM NAGY DHE BRIGITTA  
NAGYNÉ BELÉNYI**

Bëj atë që nuk e bën tjetri, që nesër të mund të bësh atë që nuk mund ta bëjë tjetri!

**GÉZA VARGA DHE ILONA  
VARGÁNÉ DR. JURONICS**

Krijë një të ardhme të tillë, që të jenë vlera njerëzore që mbeten gjatë.



**TIBOR LAPICZ DHE  
ORSOLYA LAPICZNÉ LENKÓ**

Nëqoftëse njeriu ka Objektiv dhe Besim, pengesat përkulen para tij.

**DR. KATALIN PIRKHOFFER DR.  
SERESNÉ DHE DR. ENDRE SERES**

“Para teje beteja, para teje një front,  
I dobëti dorëzohet, i forti reziston.  
A e di ç’është forca?- Ajo është vullnet,  
Që herët a vonë, kurorë fitoreje do të jetë.”  
*(Arany János)*



## SERBI



**VERONIKA LOMJANSKI  
DHE STEVAN LOMJANSKI**

Ke dëshirë apo jo, kjo varet nga zgjedhja Jote. Vendosëm që ta duam! Punë, Rregull dhe Vetëdijësim. Foreveri është një rrugë që të çon tek suksesi, tek paraja dhe tek një jetë më e mirë.

**DR MARIJA RATKOVIĆ**

Jam e lumtur që 12 vjet më parë kuptova vlerën e vërtetë të produkteve të FLP dhe atë që të ndihmoj shumë njerëz për arritjen e ëndërrave të tyre!



**MARIJA BURUŠ DHE  
BOŠKO BURUŠ**

FLP të ofron mundësinë e një jete më të bukur, më të mirë dhe më cilësore. Foreverin e pamë si një sfida, por sot e kemi stil jete!

**MIRJANA MIĆIĆ DHE  
VILMOŠ HARMOŠ**

U bëmë bashkpunëtorë të FLP gjatë kërkimit të qëllimeve më të mira, më të mëdha, më të gjëra, më humane dhe më të largëta. Të bëjmë atë që duam dhe ta duam atë që bëjmë.



## SERBI



**DRAGANA JANOVIĆ  
DHE MILOŠ JANOVIĆ**

Ne nuk punojmë në FLP, ne jetojmë stilin e jetës të FLP, udhëtojmë, shtojmë të njohurit, ndihmojmë miqtë e skuadrës tonë të shkëlqyer për arritjen e objektivave të tyre. Faleminderit Rex, faleminderit FLP!

**DR ALEKSANDAR PETROVIĆ  
DHE MIRJANA ĐUKIĆ-  
PETROVIĆ**



Jemi menaxherë që nga 2007. E kuptuam se qëllimet e jetës sonë mund ti arrinim vetëm duke punuar në një kompani të tillë si Forever Living Products.

## KROACI



**MAJA STILIN DHE  
TIHOMIR STILIN**

Fillimi ishte i vështirë, por mbasi Tihomiri arriti të ndryshojë Majan, eci shumë më lehtë dhe shumë më shpejt. Bashpunëtorët ndjekin sponsorit e tyre, Tihomirin dhe me punën e skuadrës arritëm tek objektivi. Ndiqni më të sukseshmit, ndryshoni, mësoni dhe do të arrini qëllimin e dëshiruar!

**JADRANKA KRALJIĆ-PAVLETIĆ  
DHE NENAD PAVLETIĆ**



Tek Foreveri të gjithë neve përjetojmë ndjenjën festive të një jete të lumtur dhe të mundësive të pafundme që na ofrohen!

## SLOVENI



**JOZEFA ZORE**

„Nuk ka rëndësi sa e ngushtë është porta, dhe me sa dënime të rënda është mbushur pergamenti i horoskopit tim, sepse unë jam vetë zot i fatit dhe kapiten i shpirtit tim.”  
(William Ernest Henley)

**ANDREJA BRUMEC  
DHE TOMISLAV BRUMEC**



Mos u kënaq me atë që je, nqse nuk do të mbetesh ai që je, sepse aty ku kënaqesh aty mbetesh. Duke u përqëndruar ngadalë tek objektivi, arrin shumë më tepër nga ata që kosisin pa objektiv. Ju urojmë suksese dhe rezultate sa më të larta!

## BOSNJE-HERCEGOVINA



**VASILIJE NJEGOVANOVIĆ**

E gjithë familja ime punon në mënyrë aktive në FLP. Edhe djali e vajza janë menaxherë, dhe jam krenar për ta si për bashpunëtorët e tjerë. Në këto kohë të vështira uniteti dhe besimi në punën tonë sjell rezultatet e dëshiruara. Jam shumë i lumtur që jam anëtar i perhershëm i Klubit të Presidentit. I vlerësoj së tepërmi sponsorit e mij dhe ata që janë më të mirë nga unë, ndërsa mësimet e tyre ua trasmetoj të tjerëve.

**SUBHIJA MUSTAFIĆ  
DHE SAFET MUSTAFIĆ**



Baza e planifikimit të të ardhmes tonë nga FLP, që ndikon edhe mbi tërë jetën tonë, është ajo që gëzojmë sot, të jemi të gatshëm për sfidat e të nesërme, ndërsa pengesat e papritura na japin forcë në rrugën që të çon drejt arritjes të objektivit.





# PHÖNIX

BUDAPEST KFT  
AGJENSI BILETASH AVIONI



**ZSUZSANNA GERŐ**  
Prenotime në grup, rally

**Kontaktim:**

1183 Budapest, Nefelejcs u 9–11.  
Tel: +36 1 269 5370/158  
Mobil: +36 70 436 4272  
e-mail: rally@flpseeu.hu



másképp / mint mások

PRENOTIM I THJESHTË  
BILETASH AVIONI PËR NË  
ÇDO VEND TË BOTËS



**GABRIELLA PITTMANN**  
Prenotime personale

**Kontaktim:**

1067 Budapest, Szondi u. 34.  
Tel: +36 1 373 0025  
Mobil: +36 70 436 4297  
e-mail: repjegy@flpseeu.hu

PËR BLERËSIT TANË TË BILETAVE TË AVIONIT, ÇDO TREMUJOR HEQIM SHORTIN  
PËR NJË DARKË EKSKLUZIVE PËR 2 VETË NË RESTORANTIN „SASFÉSZEK”



Më 20 Maj 2011

## NË BUDAPEST DO TË ZHVILLOHET PËRSËRI „DITA E SHËNDETIT”!

- kontroll i përgjithshëm mjeksor
- biseda për çështje të ruajtjes të shëndetit
- programe argëtuese për fëmijë dhe për të rritur

**JU MIRËPRESIM TË GJITHË MIQTË E DERI TANISHËM DHE ATA QË DO TË VIJNË!**





ÉVA BUDAI-SCHWARCZ DHE TAMÁS BUDAI

**„NËQOFTËSE KE OBJEKTIVA,  
NUK ËSHTË E VËSHTIRË”**



## **Keni filluar në vitin 2002, pra nëntë vjet me Foreverin, me sa dimë, atëhere i vetëm.**

**Tamás:** Po, sponsori im ishte ish bashkëshortja ime Senior menaxherja Judit Sebók.

Me bashkëshorten e tanishme Évi, jam njohur vetëm në 2005, por biznesin nuk e bashkuam menjëherë, ajo filloi punë me mua mbas 2 vjetësh.

## **Pse vendosët të lidheshit me këtë firmë?**

**Tamás:** Edhe më parë kisha punuar në rrjetë në shitje direkte. Por erdhi një pikë kur e ndjeva, megjithë sa kisha bërë, nuk kisha arritur suksesin që prisja. Deri në shpërthimin e vërtetë, edhe këtu nuk e kisha arritur, por ky është një qëndrim i imi i kaluar.

## **Çfarë shikon gabim me syrin e sotëm?**

**Tamás:** Në fillim u lidha me bashkshorten time si një lloj sigurie, nqse ajo e ka bërë pse të mos e bëj edhe unë. Por për shumë kohë më interesonin vetëm distiktivët, të jem më lart se ata që janë rreth meje. Gjithmonë kam qënë një tip garues, dhe nuk doja të mbetesha tek „masa”. Vetëm mbas nja dy vjetësh e ndjeva vërtet se ky ishte një lloj uni por tashmë forca shtytëse ishte e të tjerëve. U shfaq egoja që të dalësh në majë, duhet një grup i fuqishëm, me drejtues që kërkojnë shumë, me objektiva më të larta. Atëhere filluam të rriteshim vërtet.

## **Përmende „objektiva më të larta”. Kjo do të thotë nivelin diamant?**

**Tamás:** Sigurisht, edhe diamant do të arrij, kjo është e sigurtë. Është energji e investuar dhe çështje kohe, por do ta arrij. Dhe jo për para. Më përpara na vinte në lëvizje paraja, tani është egoja që e duam më shumë se parën. Kur dëshiron të fitosh e arrin, por jo vetëm, por me skuadrën.

## **Dhe gjithmonë duhet të jesh në krye?**

**Tamás:** Pse, ka tjetër? Ka tjetër garues? Ky është një biznes mekaniku, nqse e bën ke rezultat nqse nuk e bën, nuk ke gjë. Gjithkënd e pengon vetvetja dhe kjo është e vërtetë në çdo fushë të jetës. Njerzit prettojnë vetë, por nuk kanë rezistencë. Edhe unë kisha një periudhë kur kështu isha, mjaft kam, s’kam pse ta shtoj rrjetin. Që nga ajo kohë e kam kuptuar se ajo ishte vetëm një fazë e zhvillimit. Jam një i pakënaqur i perjetshëm, që herët më ka dëmtuar, por tashmë je i shëndetshëm nqse e çon më përpara.

## **Eshte gjë e vështirë të ndërtohet rrjetin?**

**Tamás:** Nqse gjen njerzit e duhur, jo, nuk është. Më parë doja të ruaja gjithkënd, doja që të gjithë të bëheshin drejtues të mëdhenj... Është e pamundur. Sot bindem në 2-3 muajt e parë, apo edhe që në javët e para se me kë duhet të vazhdoj. Megjithë pikët që mund të bëjë, sepse mundet që të realizojë xhiron, por nuk do ta mbajë në mënyrë të vahdueshme, nqse nuk ka personalitetin e duhur. Ata janë njerëz të mirë që sakrifikojnë rehatin e sotëm për të nesërmen dhe ndërkohë shvillohen edhe si njerëz. Në këtë biznes ndoshta më e vështira është ajo që të luftojmë me vetveten. Një njeri është vërtet i mirë vetëm kur e shikon rrugën dhe mua gjithmonë më sfidon. Sa më shumë menaxher ke, aq më pak kohë duhet duhet të harxhosh me këta.

## **Domethënë edhe ti zhvillohesh.**

**Tamás:** Si jo. Mbasi sa më shumë aftësi ke aq më shumë mund ti zotërosh gjëra të tilla. Mua kot do të ulje në vëndin e Artilla Gidofalvit, nuk do të mund ta zotëroja atë që ai ka. Jo pse nuk do të dija si ti shpenzoja paratë, por nuk kam aftësinë për atë që ti kontrolloja, ti edukoja, ti menaxhoja gjithë ata që ecin me atë. Kur rritet bonusi „kurdiset” personaliteti, pastaj një personalitet më i mirë rrit bonusin e kështu me radhë. Shumë herë jam i paduruar, por nuk lejohet. Më parë ua prisja fjalën njerzve, por tani dua më shumë tua jap atyre atë. Kjo është detyra: pushtet pa udhëheqje. Kështu mund të jem perandor që kam shumë mbretër poshtë meje, por që nuk e ndjejnë dallimin – ndërtojmë perandorinë por si partnerë.

## **A të besojnë?**

**Tamás:** Atyre duhet tu trasmetosh ëndërra të tilla që mund ti shohin – edhe me pak hapa. Por nqse vetëm u them por nuk vepro, atëhere nuk do të kenë respekt. Fatmirësisht plani i marketingut është i përshtatshëm që edhe shpejt të mund të fitosh para. Me një njeri, për pak muaj, duhet bërë ca para të mira, sepse ai tërheq të tjerët. Një herë e një kohë peshku i madh hante të voglin, sot i shpejti ha të ngadaltin.

**NË DITËN E FUNDIT TË SUKSESIT THUAJSE U FOL PËR SKUADRËN TUAJ. ANËTARË TË KLUBIT TË PRESIDENTIT, SOARING MENAXHERË, MENAXHERË TË RINJ... DUHET TË KETË DIÇKA SEKRET PËR ÇIFTIN BUDAI. NDSHTA NUK FILLON ME NDËRTIMIN E SHTËPISË? POR DO TË NA I SQAROJNË SHPEJT VETË ATA.**





**Para fillimit në FLP ishit sipërmarrës i shitjes të dritareve, por njëkohsisht edhe kampion në sport. Për çfarë mund ti jesh mirnjohës karrierës të sportit?**

**Tamás:** Për durimin tim. Në sport mësova se nqse ndjej lodhje të muskujve, kjo është normale. Nqse më dhemb diçka, ky është një stad zhvillimi. Mësova se megjithse gjithmonë ka pika rënie, pas saj gjithmonë vjen vrulli, dhe pika e rënies ka vlerë për të parë se ku kemi gabuar. Dhe nuk nxirret pergjegjsia. Prandaj ndoshta eshte më lehtë të punosh me sportistat. Dihet se energjia e investuar sot nuk ta kthen po sot, por mbas një viti. Psh nqse çdo ditë bëj një ulje-ngritje kur duhen një mijë, atëhere nesër duhet të bëj dy, pasnesër tre e kështu me radhë.

**Éva, ti si silleshe, kur bashkëshorti yt i sapo njohur bënte ulje-ngritje pranë teje?**

**Éva:** Në fillim e gjithë kjo botë, ky stil pune, mu duk e çuditshme. Unë kisha mbaruar shkollën e lartë për menaxhim, dhe në atë kohë punoja në një firmë të madhe si shefe logjistike. Në vëndin tim të punës i respektonim shumë drejtuesit, pë njohuritë e tyre profesionale, për punën e tyre. Por më pak për atë se si silleshin me vartësit. Ajo që më bëri përshtypje këtu ishte ajo që këtu kujdeseshin shumë për njerzit. Deri atëhere, mardhëniet hierarqike, qëndrimin larg i kisha imagjinuar si shfaqjen e një drejtuesi të mirë.

**Punë shumë... keni vogëlushen Jazmin një vjeçe. A mundet Tamás të jetë edhe një baba i mirë?**

**Éva:** IPo, sepse është e vertetë që në shtëpi kthehet nga ora 10-11, dhe atëhere i duhet të shikojë e-mailët. Por tani nuk është si më parë që edhe në mesnatë e thërrisnin për diçka. Kemi vendosur një ekuilibër. Çdo javë një ose dy ditë qëndron në shtëpi, dhe po nuk u anulua ndonjë takim, menjëherë vjen në shtëpi. Ka periudha kur nuk është shumë aktiv. Kështu ishte edhe mbas lindjes të vajzës. Çdo dy javë i vijnë djemtë dhe perpiqet që sa më shumë të qëndrojë me ne. Tek shumë njerëz shikoj që i armiqson biznesi, sepse nuk kanë kohë të rrinë me bashkshortien ose bashkshortin e tyre. Sekret i qëndron në atë që gjërat të bisedohen më parë. Nqse bashkëshorti apo bashkëshortja e di pse tjetri ikën nga shtëpia, pse e bën gjithë këtë, atëhere kuptohen me njeri tjetrin. Ka momente më të vështira, por që duhen biseduar më parë dhe të dilet prej andej, nuk duhet që tjetrit t'ia përplasësh gjërat në kokë. Për

Tomin ky është një mision dhe nuk mund të tërhiqet edhe sikur të doja unë. vetëm do të çonte në prishjen e mardhënieve.

**Tamás:** Një periudhë kam qënë vertet manjak i punës, por tani nuk është kështu. Njeriu ngopet në familje, vetëm kështu është i plotë. Ai që nuk i ka gjërat në rregull në shtëpinë e tij a inuk është i plotë. Dhe ka rëndësi që njeriu të jetë shëmbull në çdo aspekt, sepse drejtuesin e shikojnë, nuk mund të hiqesh baba i mirë, sepse njerzit të shikojnë brënda familjes tënde. Nga ana tjetër nqse vetëm ecën nga mëngjezi deri në mbremje kjo nuk është ndonjë model tërheqës për askënd. Njerzit do të donin të shikonin një mënyrë jetese ku jetohe mirë, dhe këtu nuk kemi parasysh vetëm paratë por edhe harmoninë. Me karatenë dolëm kampionë në Amerikë, që eshte një gjë e mirë, por kupat e medaljet janë gjëra të shkuara. Këtu është shtytja, ku krijojmë gjëra që mbeten. Për mua përshembull ka rëndësi edhe ajo që fëmijët e mij ti shikojnë rezultatet. Në fëmijrinë time, për mua modele ishin Bruce Lee dhe Chuck Norris. Babain e respektoj, sepse eshte njeri shumë i mirë, por kurrë nuk e kam menduar si model. Tani im bir ka përgatitur vetë një fletore të veçantë, dhe thotë se të dy (*Balázs 13, dhe Dávid 11 vjeç – Red.*) do të bëhen ndërtues të rrjeteve... dhe do të jetë një gjë shumë e mirë, që në moshën 18 vjeç ti kenë duart të lira, sepse dua tu jap edhe shëmbullin, e jo vetëm paratë. Prandaj i marr ata në skenë dhe u them që kur ata të kualifikohen menaxher edhe unë do të marr pjesë në ceremoninë e kualifikimit pranë tyre.

**Anë botën e ëndërrave të tua cilat kanë qënë shkallët më të rëndësishme?**

**Tamás:** Biznesi i menaxherit, kur fillova nuk mendoja se do ta bëja. Ose kur kisha menaxherin tim të dytë, pastaj stimuli i makinës, edhe ajo për shumë kohë ishte në kategorinë e ëndërrave. Pastaj kualifikimi Soaring menaxher dhe rally i 2005. më vonë dy nga bashkpunëtorët e mij **Agi Klaj** dhe **Csaba Juhász** me bashkshortët e tyre u bënë anëtar të klubit të presidentit, që dhamë diçka dhe atom ë tej u zhvilluan në mënyrë të pavarur. Megjithatë momentet më të bukura janë kur miqtë e mij më të mirë u bënë menaxherë. **György Nagy** dhe **Agi Pezenhoffer** pritën 9 vjet, por megjithatë sot qëndrojnë pranë nesh! Sikur të ishe inxhinjer, gjithshka e ke parë më përpara në tavolinën e projekteve dhe kur ngrihet godina dhe kalon andej dhe me kënaqësi sheh rezultatit: eshte një gjë e mirë e dubluar mirë.





### Éva, Tamási për paratë flet sa më. Në raport me ty kjo si qëndron?

**Éva:** Unë jam e përqëndruar tek familja, nqse e di që do ti vijmë fëmijët, e planifikoj se ku do shkojmë dhe çfarë programi do kemi. Për këto gjëra mendoj zakonisht dhe jo se çfarë do marr. Përshtypjet më të mira, sepse është fakt që pa Tamás nuk do të kishim shkuar në Hawai, në Bahama apo në Florida...

**Tamás:** Pratë janë një gjë e rëndësishme, por paratë nuk duhet vetëm ti ruash por duhet ditur edhe ti prishësh. Tamam si ajri, nuk duhet vetëm për të marrë frymë por edhe të ajrosesh. unë gjithnjë i pyes njerzit, po sa prishni për vete? Nuk mendoj thjeshtë për rroba, por sa shpenzon „për trurin tënd”. Kush shpenzon gjysmën e bonusit për trainim? Unë për 6 muaj kam shpenzuar 5 milion, për tu përgatitur si një drejtues i mirë. Ky është investim për veten. Është e vertetë që përgatitemi për ndërtimin e shtëpisë, por këto pare do ti nxjerr nga shumta e caktuar për të. Mësuarja është më e rëndësishme se nga ajo do të vijë edhe shtëpia. Halli është që njerzit harxhojnë më shumë për ndërtimin e shtëpisë.

### Përmendët nivelin diamant. Çfarë pune ju duhet për të arritur atë që keni planifikuar?

**Tamás:** Gjithnjë i jap vetes një afat. Diamanti është pak evaziv, titullin zafir tashmë e shikoj. Objektivat nuk janë irrealë sepse unë i bëj vetë. Biznesi ndërtohet nga vrulli. Ka patur raste që kam djersitur trefishin dhe nuk ka ecur, por ka patur edhe raste të tilla që me gjysmën e asaj energjie kam realizuar shumfishin. më përpara nuk kam e kam mbajtur distinktivin por sot me këtë respektoj ata të cilëve u jam mirënjohës. Por njëkohsisht kjo është e shkuara, unë përqëndrohem tek e ardhmja, kërkoj ata njerëz me të cilët mund të ngre një skuadër më të madhe.

### A ka fusha për të zbuluar e pushtuar?

**Tamás:** Sigurisht. Nqse shikon mjedisin që na rrethon, situata nuk është më e mirë. Edhe në farmaci po futen gjithnjë e më tepër preparate natyrore, bota është e hapur për produktet tonapor edhe situata ekonomike punon për ne. Mbasi po humbe shëndetin ke humbur edhe punën. Unë gjithkujt i them: ruaj shëndetin sepse mëndja është e shëndosh në trup të shëndosh. Ushqeu si duhet sepse edhe fëmijët këtë do të mësojnë. Sipas meje sot është më lehtë për biznesin sesa në kohën kur e kam filluar unë.

### Po juve Éva, kur keni filluar? Në 2007?

**Éva:** Situata ime është tjetër, me ndërtimin e rrjeteve më tepër është marrë Tamás ndërsa unë e kam ndihmuar me sa kam mundur, sigurisht nëpërmjet meje janë lidhur shumë njerëz, por unë jam specializuar për produktet Sonya, sepse kjo më parë në grupin tonë ishte një zonë e zbuluar. Kur fillova për herë të parë me setin Fleur de Jouvence, mendova që këtë duhet ta njohin sa më shumë gra, sepse është shumë e mirë. Nqse beson në të, mund tu thuash me siguri sa e mirë është, sa u shkon njerzve. Fillova të bëj prezantime, ndërkohë mësova shumë, vajta në trainime, dhe që nga ajo kohë kemi bërë mjaft punë. Tani nuk punoj shumë, duhet të kujdesem një çikë për bebin, ta shfrytëzoj këtë kohë, ta perjetoj çdo minutë. Por ka patur edhe raste që Jazminen e kemi marrë si kangur për të realizuar prezantimet, edhe këto ndodhin. Ndofta i ka pëlqyer edhe asaj... është fakt se fëmija e ndryshon shumë njeriun, tjetër bëhet ndjenja e përgjegjesisë, kështu që tashmë Ajo është e para.

### Po Tamási si ndihet si baba i një vajze?

**Tamás:** Jashtzakonisht mirë, por vërtet nuk bëj dallim, për fat të keq kur djemtë ishin të vegjël nuk kam qënë baba shumë i mirë, për këtë shumë kohë më ka vuarë ndërgjegjia, që me ndarjen shkaktova një thyerje në jetën e tyre, por jam krenar që me ish bashkshorten time jemi një shembull rrallë në firmë që kemi mundur ti ruajmë mardhëniet miqësore dhe ajo është sponsori im. Kam bërë gjëra të gabuara në jetë, por këtu pata shansin të bëhem njeri, dhe nuk më vjen turp. E kam zakon ta tregoj sepse nuk mbaj dot maskë. Dikur doja të isha si Robi Varga, si Pista Halmi etj, tani jam vetvetja dhe kam heqë dorë nga çapëllëqet. Po të kesh një objektiv nuk është vështirë. Për mua pati shumë rëndësi që rash në një linjë sponsori të mirë. Shumë mirënjohës jam ndaj ish bashkshortes time, nga çifti Bakó kam mësuar shumë, por ka njerëz me objektiva të qarta si **Tünde Hajcsik** e **Zsolt Fekete** me të cilët jam konsultuar, **Zsolt Leveleki** që e mban grupin të bashkuar, **Vali Dobai**, **Csaba Juhász** dhe **Enikő Bezzegh**, **Ági Klaj** dhe **Laci Rostás**, **Zsolt Zachár** dhe **Izabella Zachár-Szűcs**, **Annamária Szűcs**, **Róli Szabó**, **familja Borbély**, **grupi Kemenczei**, **Hajni Senk**, **Pisti Halmi**, **Robi Varga**... më duhet ti rreshtoj sipas emrave, nga secili mund të mësosh dhe nuk mjafton ti falnderoj.



NEW GENERATION NEW NEW GE

**BREZI** | RI



NEW GENERATION  
GENERATION NEW GENERATION



**Zhvillimi teknik i 30 vjetëve të shkuara, edhe për FLP hapi dimensione të reja në fushën e ndërtimit të rrjeteve. Që nga krijimi i kompanisë më 1978 të gjithë gjeneratatave të distributorëve u janë vënë në dispozicion mjete dhe metoda gjithnjë e më të reja, duke mbështetur kështu biznesin e tyre të ndërtimit të rrjeteve. Teknologjia aktuale, për mundësitë e e biznesit të ofruar nga FLP bëhet tërheqëse vecanrisht për brezin e moshës 18 deri 30 vjeç. Padyshim, zhvillimin dhe forcën e ardhshëm të kësaj kompanie të madhe kryesisht do ta shfytëzojë brezi i ri. Por duke u nisur nga kjo edhe zhvillimi dhe forca e ardhshme i sipërmarrjes tuaj do të varet nga ajo sa i aftë do të jesh ti sponsorizosh këta të rinj në grupin tënd.**

**D**isa herë hezitohet, kur duam të afrojmë të rinjtë me mundësitë e këtij biznesi. Ndoshta mendojmë që nuk janë akoma të pjekur, që ta vlerësojnë këtë që u ofrojmë, ; ndofta nuk e kanë marrë seriozisht jetën, ; apo nuk kanë synime dhe ëndërra, pa folur pastaj për ambiciet e tyre për realizimin e tyre. Ky është një konceptim komplet i gabuar.

Në bazë të përvojës time personale mund të flas për sponsorizimin e të rinjve, sepse edhe unë dikur isha pjesë e tyre. Qysh në moshën 15 vjeç munda të njihem me marketingun në rrjet (MLM) , shumë vite para se të ngrihej këtu FLP. Megjithatë zyrtarisht nuk mund të bëhesha distributor deri në moshën 18 vjeç, unë ndihmova prindërit në prezantimin dhe publikimin e produkteve dhe të mundësive të biznesit. Që në atë kohë kisha dëshirë të fitoja shumë para, dhe kjo dëshirë u rrit, kur hyra në të njëzetat , u martova dhe u bëra me fëmijë. Kisha mbushur 20 vjeç kur u lidha me FLP, dhe atëherë edhe mua kështu më shikonin si një pjestar të brezit të ri. megjithatë i ri munda të shikoj sesi të tjerët kishin suksese të mëdha biznesi me MLM dhe vendosa që edhe unë do ta arrij këtë me FLP.

FLP më tërhoqi sepse në atë kohë përdorte teknologjinë më moderne, që u bënte të mundur distributorëve ti blenin produktet direkt nga kompania dhe të merrnin edhe bonuse. Kisha mjaft ambicie dhe energji , që ta nisja këtë dhe të realizoja objektivat e mia. Por faktori më i rëndësishëm i i sukseseve të mia u bë linja sipër meje. Sponsorit e mij që më mbështetën në rrugën që të çon tek suksesi, ishin pjestarë të gjeneratës të distributorëve para meje. Ndhimë vecanrisht të madhe më dhanë kur në rrjet futa njerëz të rinj. Me sukseset e arritura dhe me përvojën e tyre , ata më ndihmuan të fitoja aftësitë që nuk i kisha për shkak të moshës. Të rinjtë sot kanë po ato dëshira që lidhen me suksesin dhe pamvarësinë materiale, siç i kisha edhe unë kur isha në moshën e tyre. Fatmirësisht , kompania vazhdimisht

nxjerr produkte të reja dhe aplikon teknologjitë më të reja , kështu gjithmonë ka mundur të mbajë hapin me kohën dhe për brezin më të ri ka mundur të jetë tërheqëse. Teknologjia më moderne e aplikuar nga Forever Living përfshin në vetvete shitjen e produkteve edhe nëpërmjet Internetit, drejtimin dhe publikimin e sipërmarrjeve të distributorëve të vet me MyFLPBiz, Facebook, Youtube, dhe FLP media.com duke dhënë mundësi për prezantimin dhe publikimin e produkteve dhe biznesit të saj, si dhe për futjen në qarkullim të produkteve shumë të pëqyera nga brezi më i ri sikurse janë: **FAB Forever Active Boost™ Natural Energy Drink (321), Aloe Sunscreen Spray (319) dhe ARG1+™ (320) .** Të gjitha këto të marra sëbashku, sot i bëjnë vertet tërheqëse mundësitë e ofruara nga FLP për të rinjtë. Pra mundësitë për ti futur ata në këto rrjete nuk kanë qënë kurrë kaq të mira. Prandaj ju inkurajoj të bisedoni me të rinjtë për ëndërrat dhe synimet e tyre, të ndajmë me ata njohuritë që kemi për produktet tona prallore dhe tu tregojmë atyre se si mund të sigurojnë me FLP një burim të ardhurash të perjetëshme. Unë gjithë këtë e kam arritur në Forever Living dhe u jam jashtëzakonisht mirënjohës atyre , që më kërkuan mua, kur isha i ri dhe më treguan se si mund ta bëja këtë punë.

**Bill Lewis**  
**Zëvendës president i FLP,**  
**përgjegjës për çështjet**  
**operative**



Shumë ia njohin bukurinë kësaj luleje që zbukuron kopshtet në verë, e quajtur luledashi ose shkencërisht Echinacea. Që është e bukur, ajo duket. Por çfarë cilësish ka si bimë medicinale, kjo është një surprizë e vërtetë!



## Echinacea – mbrojtësja e përditshme

**E**chinacea, apo luledashi është cilësuar edhe „lulja e dashur” sepse petalet e saj kanë zënë vend në follenë ngjyrë kafe formë rrezesh duke formuar një filxhan, dhe ngjyra e tyre nga pushi që vishen është në ngjyrë trëndafili të ndezur dhe të kuqe të venitur. Prej kësaj merr edhe emrin luledashi e kuqe, lulefilxhani etj.

Emri Echinacea e ka origjinën nga fjala greke echinos (iriqi), duke e marrë këtë kuptim edhe nga qendra e lules që i ngjan një iriqi por edhe nga gjëmbat që ka duke siguruar një mbrojtje. Sipas botanistëve me emrin Echinacea lidhen 17 variete, nga të cilat vetëm 3 variete kanë efekte kurative: Echinacea purpure (luledashi e kuqe), Echinacea angustifolia (luledashi gjethe hollë) dhe Echinacea pallida (luledashi e venitur). Ajo rritet në mjedise të pyjeve të thata, në pllajtat me bar si përshebull në Amerikën Qendrore-Perndimore, ndërsa në Europë ajo kultivohet në brezin klimaterik të butë si lule zbukurimi dhe si bimë medicinale.

### HISTORIA E PERDORIMIT TË SAJ

Historia e Echinaceas shkon larg, mbasi indianët e pllajave të Amerikës Veriore e kanë përdorur si ilaç përparësor. Çajin e ngrohtë të rrënjëve të saj e kanë përdorur për lloje të ndryshme plagësh, për pickime insektesh e këpushash,

si dhe kafshime gjarpëri. Ajo është përdorur gjithashtu për gargar për dhembje të dhëmbëve dhe mishrave të dhëmbëve, dhe e kanë pirë si çaj kundër ftohjes, lisë, fruthit, shytave dhe kundër anjtjeve të kyçeve.

Evropianët që u vendosën në rrafshnaltat e Amerikës Veriore e njohën dhe e përdorën atë si ilaç popullor deri në vitet 1870, kur furnitori me ilaçe Dr H.C.F Meyer nga qyteti Pawne në Nebraska, mori patentën e përgatitjes prej Echinaceas të ilaçit „Mayer” për pastrimin e gjakut.

Ilaçi u shpall si „mjekuesi absolut” i kafshimit të gjarpërit me zile, helmimin e gjakut dhe një sërë sëmundjesh të tjera. Sipas ruajtjes të patentës këtë ilaç e njohën me emrin „vaji i gjarpërit”

Kurrë nuk e treguan sesi e kuronte kafshimin e gjarpërit me zile, por një numur studimesh bien dakort për atë që 3 lloje të Echinaceas (*Echinacea purpurea*, *Echinacea angustifolia*, *Echinacea pallida*) zotërojnë që nga rrënja deri tek lulja shumë veti kuruese që meritojnë vëmendje.

### LËNDËT QË KANË EFEKT

Lëndët me efektin më të rëndësishëm të Echinaceas janë arabinogalaktanet imunostimuluese (*polisaharidet bimore*) që lidhin viruset dhe bakteriet që hyjnë në



# Pasuritë e natyrës II.



organizëm duke tërhequr prej andej ruazat e bardha (limfocitet-T) dhe shtojnë numurin e tyre , duke rritur me këtë aftësinë rezistuese të organizmit.

**Polisaharidet:** janë karbohidrate me molekula të mëdha, që formohohen

**Limfocitet-T:** Limfocitet-T janë qeliza imune ,pjesmarrëse të domosdoshme në reaksionin apo reagimin imun.Piqen dhe prodhohen në timus (gjëndërrat e foshnjës) (gjithashtu në moshën e re formohen edhe në palcën e kockave ). Janë qeliza përgjegjëse për përgjigjen imune qelizore.

Këto efekte i përforcon përmbajtja acidit çikor të *Echinacea purpurea* (derivat i acidit të kafes) dhe përmbajtja echinakozide (derivat i acidit të kafes)

e *Echinacia angustifolia*, komponentë që kanë karakter pengues të viruseve, bakteriostatik dhe paksues të infeksioneve.

**Derivati acidit të kafes:** (C<sub>9</sub>H<sub>8</sub>O<sub>4</sub>) është komponent organike natyral (i ngjashëm me alkolin) që gjëndet në një numur frutash, zorzavatesh e bimësh , ndërmjet të cilave edhe te kafeja.

**Bakteriosstatik:** në mikrobiologji bakteriostatika nënkupton atë efekt, në të cilin bakteriet ndalojnë ndarjen e qelizave me mjete antibakteriale

*Echinacia* përmban gjithashtu si lëndë të efektshme vajin esencial, alkilamide, flavonoide, poliacetilene dhe vitaminë C të cilat janë në sasi të ndryshme sipas llojeve të echinacias.

# nature

**Vaji esencial:** Vajrat esenciale janë lëngje që nuk përzihen me ujin që përmbajnë komponentë aromatikë të cilat nxirren nga bimët.

**Alkilamid:** komponent hidrokarburi me përmbajtje nitrogjeni (komponente organike me përmbajtjen më të thjeshtë të hidrokarbureve të cilat në natyrë mund të gjënden me shumicë në vajguri dhe në gazin natyror)

**Flavonoid:** Flavonoidet janë një grup komponentesh me efekt kurativ që gjënden me shumicë në botën bimore. Cilësitë e shumë bimëve medicinale shikohen pikërisht tek flavonoidet. Emrin flavonoide e kanë marrë nga ngjyra e tyre e verdhë, ato thithin dritën ultraviolette kështu përmbajtja flavonoideve e luleve për insektet ka efekt tërheqës.

**Poliacetilen:** është një nga komponentët hidrokarbur organik me përbërjen më të thjeshtë që në natyrë mund të gjënden me shumicë në vajguri dhe në gazin natyror.

## PERDORIMI TERAPIK

Echinacea përmirëson funksionin e sistemit imun, domethënë aftësinë mbrojtëse të organizmit. Kështu jo vetëm nxit funksionimin e sistemit imun, por edhe normalizon, përgjigjen e tepërt imune (reaksionet alergjike, proceset autoimune). Prandaj në sajë të efektit pozitiv që ushtron mbi sistemin imun ajo përdoret jo vetëm si plotsues por edhe si parandalues për kurimin e ftohjeve të lehta e të mesme.

Echinacea në sajë të efekteve natyrore antimikrobe që shkaktojnë sëmundje të bakterieve, viruseve, mykut etj mund të përdoret në shkallë të gjërë për lehtësimin dhe shkurtimin e kohës gjatë sëmurjes nga ftohja, nga gripi si dhe nga infektim i rrugëve urinare. Shumë vetë nuk e dinë se në infeksionet bakteriale të rrugëve të frymëmarrjes ajo rrit efektin antibiotik, por edhe në rastin e infeksioneve të rrugëve urinare mund të jetë me efekt pozitiv. Falë efektit të paksimit të inflamacioneve, është e përdorshme edhe në parandalimin e proceseve inflamatore si dhe në terapinë plotsuese të mjekimit të plagëve. Nëqoftëse doni një sistem imun të fortë dhe një mbrojtje të mirë nga sëmurjet e shpeshta, zgjedhja më e mirë është kosumi afatgjatë i Echinaceas!

## LITERATURA

- ESCOP Monographs 130. oldal
- WHO monographs on selected medicinal plants Volume 1
- WHO 1999 Geneva p.136-144
- Brinkeborn RM et al. Echinaforce and other fresh plant Echinacea preparations in the treatment of the common cold Phytomedicine 6[1], 1-6. 1999
- Lindenmuth GF, The Lindenmuth B. Efficacy of Echinacea Compound Herbal Tea Preparation on the Severity and Duration of Upper Respiratory and Flu Symptoms: A Randomized, Double-Blind Placebo/Altern Controlled Study Complement Med 6[4], 327-334. 2000
- Goel V et al. Efficacy of a standardized Echinacea preparation Echinilin for the treatment of the common cold: a randomized, double-blind, placebo-controlled trial Phytother Res 19[8], 689-694. 2005 Echinacea
- Linde K et al. for preventing and treating the common cold (Review) Cochrane Database Syst Rev 1, CD000530. 2006
